



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269627
Datë: 24.02.2021
Numri i dokumentit: 01538545

A.nr.515/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu, në konfliktin administrativ të paditësve NTSH "D...", NTSH "D...", NRSH "K..." Sh.p.k. "L...", DPD "P...", firma "R..." dhe NSH "K..." të gjitha me seli në Prishtinë, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Vehbi Halili, avokat nga Prishtina, Rr. "UÇK-së" numër 28, kundër të paditurave Komuna e Prishtinës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me seli në Prishtinë si dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimeve kontestuese, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datë 01.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve NTSH "D...", NTSH "D...", NRSH "K..." Sh.p.k. "L...", DPD "P...", firma "R..." dhe NSH "K..." të gjitha me seli në Prishtinë, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Vehbi Halili, avokat nga Prishtina, Rr."UÇK-së" numër 28.

II. ANULOHET Vendimi 01.Nr. 400-93043 i Komunës së Prishtinës, Konkluzioni Nr.92/18-02/D i datës 27.02.2018 i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Vendimi i datës 01.03.2017 i KBI-së dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek të paditurat.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me praninë e palëve paditëse si dhe në praninë e të paditurave.

Paditësit me padinë e datës 23.03.2018 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.01.2021, kanë kërkuar nga Gjykata që të anulohet Vendimin 01.Nr. 400-93043 i Komunës së Prishtinës, II.2. Konkluzionin Nr.92/18-02/D të datës 27.02.2018 i Autoritetit Kosovar të konkurrencës dhe Vendimin e datës 01.03.2017 i KBI-së.

Në padinë e tyre, paditësit pohojnë se Komuna e Prishtinës bën favorizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës pa e precizuar se çka kanë të drejtë ata si Bashkësi Islame, ku BIK në mënyrë të

kundërligjshme i bën shumë shërbime siç janë shitja e dërrasave, shitja e piramidave, shitja e materialit shtofit qefinit për kufomë, shitjen e kurorave edhe hapjen e varrit ku sipas vendimit të Komunës është e obliguar “*Hortikultura*”, kurse neve si firma private në dëmton me një konkurrencë duke na penguar në ushtrimin e veprimtarisë tonë të bazuar në kodin e punës. Në këtë drejtim, paditësit pohojnë se i janë drejtuar Autoritetit Kosovar të Konkurrencës i cili me konkluzionin apo aktin administrativ kontestues thotë se nuk ka bazë ligjore për fillimin e hetimeve për BIK, ku bjen në kundërshtim me vetveten duke anashkaluar mos zbatimin e nenit 10, nenit 11, nenit 12 dhe nenit 48 e 54 të Ligjit nr. 03/L-229, ligj ky i cili në mënyrë specifike i përcakton konkurrencën në raste të veçanta dhe në këtë rast e favorizojnë Bashkësinë Islame, gjegjësisht Këshillin e Bashkësisë Islame në Prishtinë që edhe më tutje të veproj kundër këtyre firmave private.

Paditësit po ashtu pohojnë se edhe vendimi i KBI-së Nr. 45/17 të datës 01.03.2017 i detyron familjarët në mënyrë obligative në rast të vdekjes të anëtarit të ngushtë të familjes, të lajmërohen në këtë bashkësi, përndryshe Bashkësia Islame nuk do të merr asnjë rast, edhe asnjë imam nuk do i kryej ritualet ndaj familjes nëse ju drejtohet firmave private për ndonjë shërbim. Prandaj të paditurat veprojnë në kundërshtim me ligjet e cekura më lartë duke i dëmtuar firmat private në mënyrë të qëllimshme.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësve deklaroi: *“mbetem në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe provat që ja kemi ofru Gjykatës dhe do t’ia ofrojm në këtë seanc Gjykata do të arrij t’ia fal besimin paditësve dhe do ta anuloj vendimin i cili është nxjerr nga komuna e Prishtinës në bashkëpunim me bashkësinë islame dhe në kundërshtim me ligjin mbi regjistrimin e firmave që aplikohet në MTI. Gjykata shpresoj që do ta ket pataszsh këtë ligj i cili në mënyrë të perpikt e përcakton fushveprimtarin e firmave private në kodin 9303 e cila primare për firmat e regjistruara e ka veprimtarin funerale dhe të ngjashme. Ne sot Gjzkastes do tja sillim edhe nje prove një vendim të bashkësis islame e dt.01.03.2017 ne rr 45/17. Në këtë vendim shihet qëllimi i bashkësis islame tu bo presion në xhemat qe me tvetmin qellim qe ti friksoj qe të mos shkojnë në firmat private e qëllimi i tze ishte qe ti dëmtoj kto firma edhe pse jon te regjistruara në MTI. Gjykatës i dorëzoj kërkesën drejtuar bashkësisë islame te dt.17.10.2016”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësve deklaroi: *“besoj qe Gjykata pas shqyrtimit të provave do ta arrij ta anuloj vendimin e komunës i cili është në kundërshtim me interesat e firmave të regjistruara në mënyre legale dhe pas anulimit të këtij vendimi firmave Do tu mundësohet ushtrimit i veprimtarisë i paraparë në kodin 9303 , ndërsa sa i përket konkluzionit të AKK dhe vendimit të KBI EDHE KY TË ANULOHET pasi që janë penfese në ushtrimin e veprimtarive për firmat që i perfaqsoj.”*

E paditura e parë, Komuna e Prishtinës, me përgjigjjen në padi të datës 29.09.2020 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Më tutje, pohon se me provat e bashkëngjitura në padi, vërtetohet se e paditura e parë ka nxjerrë vendim bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me kompetencat të cilat i ka kryetari i Komunës e të cilat burojnë nga Statuti i Komunës së Prishtinës, me të cilin vendim lehtësohen sadopak shpenzimet e varrimit të qytetarëve të Komunës së Prishtinës, duke i dalur në ndihmë personave që parapakisht i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 2 dhe 3 të vendimit që të njëjtit të përfitojnë shumën deri 171 euro në emër të shpenzimeve të funeralit të familjarëve të ngushtë. Kjo është një ndihmë e cila ju ofrohet personave që dëshirojnë të përfitojnë nga kjo ndihmë, pa

kurfare obligimi që të njëjtit duhet medoemos të kryejnë të gjitha shërbimet te BIK-u. Andaj pretendimi i paditësve se e paditura e parë vendimin e ka të përgjithësuar dhe si pasojë BIKU i bën edhe shërbime të tjera në mënyrë të kundërligjshme nuk qëndron. Kjo për shkakun se vendimin i të paditurës i datës 29.04.2014 është i qartë dhe me nenin 1 të tij theksohet se: “vendoset që qytetarëve të Komunës së Prishtinës” t’ju paguhet shpenzimet e funeralit të ngushtë deri në shumën prej 171 eurove.

Më tutje e paditura e parë pohon se meqë për të kryer ritualet fetare, ekskluzivitetin e kanë vetëm bashkësitë fetare dhe nga fakti se “Hortikultura” është ndërmarrje publike komunale, andaj edhe është nxjerrë vendimi për shpenzimet e funeralit në shumën e lartëtheksuar, pa i detyruar qytetarët për këto shërbime por vetëm personat që dëshirojnë (neni 3, paragrafi 1 i vendimit) dhe pa e paragjykuar aspak të drejtën e qytetarëve që të kërkojnë shërbime nga ndërmarrjet private, qoftë për shitjen e dërrasave, shitjen e piramidave, shitjen e materialit shtofit qefinit, shitjen e kurorave apo hapjen e varrit, pasi vendimi i të paditurës është vetëm për shërbime të funeralit deri në shumën prej 171 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës së parë, në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: *“mbes në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve të dhëna në shqyrtimin e kaluar si dhe i bashkangjitem deklarimeve të dhëna me shkrim dhe në seancë të paditurës së dytë dhe të tretë. Edhe njëherë ritheksojmë se vendimi i të paditurës së parë i datës 29.04.2014, ndërsa padia është shtruar me 23.03.2018, andaj konsiderojmë se ndaj vendimit të lartcekur padia është e pasafatshme konform dispozitave të LKA-së dhe LPPA-së, ndërsa sa i përket përmbajtjen së vendimeve të paditësës së parë, është i ligjshëm, është nxjerrë konform dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë materie, andaj duke u bazuar në përgjigje në padi si dhe vendimin e AKK-së, konsiderojmë se i njëjti është i ligjshëm dhe i drejtë, andaj duke u bazuar në të lartëcekurat, i propozoj Gjykatës që padinë e paditësve ndaj të paditurës së parë, ta hudh si të pasafatshme ose të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar”*.

Përfaqësuesi i të paditurës së parë, në fjalën përfundimtare deklaroi: “Konsiderojmë se nga provat e administruara, u vërtetua se padia e paditësve është e pabazuar, andaj duke u bazuar në përgjigjen në padi si dhe deklarimet e dhëna në shqyrtimet gjyqësore si dhe deklarimet e dhëna të të paditurës së dytë dhe të tretë, i propozojmë Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta hudh poshtë ndaj të paditurës së parë si të pasafatshme ose të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

E paditura e dytë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, me përgjigjen në padi të datës 21.10.2020 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar duke pohuar se: *“Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun funeral ndërsa për çështjet tjera që operatorët ekonomik kanë kërkuar që shërbimet funerale të përfshijnë edhe një pjesë të shërbimeve, ritualeve fetare, kjo nuk i u lejohet pasi Bashkësitë Fetare e kanë ekskluzivitetin sipas ligjeve në fuqi dhe formës së organizimit të tyre në Republikën e Kosovës.*

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë, në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: *“AKK mbetet pranë përgjigjes në padi nr. 315/20-07D të datës 21.10.2020 si dhe Konkluzionit të nxjerr Nr. 92/18-02/D të datës 27.02.2018. AKK gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit ka gjetur se nuk ka shkelje*

të konkurrencës në tregun e transportit funeral sepse tregu është konkurues dhe nuk është i përqendruar sepse veprimtarinë e kryejnë 8 kompani transportuese andaj në përfundim të fjalës, Autoriteti e hudh poshtë padinë në tërësi sepse nuk është shkelur Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe UA Nr. 02/2018 për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant”.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë, në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Besoj që Gjykata do ta hudh poshtë kërkespadinë e palës paditëse dhe Konkluzioni i AKK-së të mbetet në fuqi. Konsiderojmë se nga provat e administruara dhe deklaratimet e palëve, AKK gjithashtu i përkrah provat e administruara”.*

Përfaqësuesi i të paditurës së tretë, në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: *“Mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe plotësimeve të mëvonshme me propozim që padia të hedhet si e pasafatshme apo të refuzohet si e pabazuar. Lidhur me theksimet e palës paditëse e cila thirret në shifrën e veprimtarisë për zhvillim të biznesit 9303, kjo shifër i përket lëmisë për të cilën paditësit janë të regjistruar në MTI, mirëpo kjo nuk do të thotë se ata edhe e zhvillojnë këtë veprimtari sepse përveç këtij fakti, për zhvillimin e veprimtarisë së regjistruar në MTI dhe atë për cilëndo veprimtari qoftë, tregtare apo hoteliere, duhet të merret licensë tek organet kompetente të posaçme, ndërsa sa i përket pretendimeve të palës paditës që thotë se e paditura e tretë ka bërë presion te pupullata sipas vendimit që u cek më sipër, edhe kjo nuk qëndron sepse marrja e vendimit nga ana e të paditurës së parë, Komunës së Prishtinës, është një veprim i drejtë dhe unë personalisht e quaj edhe human sepse sipas përvojës sime është hera e parë që një Institucion t’i del në ndihmë popullatës dhe BIK-ut andaj BIK vetëm i ka udhëzuar popullatën që konform vendimit të Komunës së Prishtinës, t’i drejtohen KBI-së si kompetente për këtë çështje andaj mbetem pranë propozimit të mësipërm”.*

Përfaqësuesi i të paditurës së tretë, në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe theksimeve duke konsideruar se me provat e administruara del i drejtë vendimi i të paditurës së tretë vendimi i të paditurës të parë si dhe i të paditurës së tretë, andaj propozojmë që kërkesëpadia të refuzohet apo eventualisht të hedhet poshtë si e pabazuar”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.01.2021, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi i Komunës së Prishtinës i dt. 29.04.2014, konkluzioni i AKK i dt. 27.02.2018, vendimi i KBI nr45/17 i dt.01.03.2017, kërkesa e dt.08.05.2017, sqarimi i komunës së Prishtinës i dt.31.08.2017 si dhe konfirmimet e regjistrimit të paditësve në ARBK.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësve lidhur me kërkesëpadinë e tyre dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi me kujdes aktin administrativ të kontestuar të të paditurës së parë, Komunës së Prishtinës dhe për të njëjtin gjeti se është i përfshirë në shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht të nenit 47 i cili përcakton, ndër të tjera se: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);*

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”. Në këtë drejtim, gjykata konstatoi se tek akti i kontestuar mungon elementi i detyrueshëm i aktit administrativ, respektivisht pjesa arsyetuese e aktit, e gjithashtu mungon edhe Këshilla Juridike cila poashtu është element i detyrueshëm i strukturës së aktit administrativ.

Për më tepër, gjykata gjeti se me vendimin e të paditurës së parë është përcaktuar, ndër të tjera se: *“në mënyrë që të shfrytëzohet e drejta e paraparë sipas pikës së parë të këtij vendimi, qytetarët që janë familjarë të ngushtë të personave që kanë ndërruar jetë, mund t’i sjellin para organeve komunale vetëm dokumentet e cekura si në vijim:*

- *Faturën për shërbimet e marra nga ndërmarrja publike komunale “Hortikultura” sh.a;*
- *Faturën nga bashkësia fetare përmes së cilës i janë kryer ritet fetare personit të vdekur në rast se funerali i të njëjtit i nënshtrohet ritualeve fetare;*
- *Faturën nga kompania përkatëse që është shfrytëzuar për transportimin e kufomës së personit të vdekur”.* Në këtë drejtim, gjykata erdhi në përfundim se e paditura e parë në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, përcakton vetëm çështjen e faturës që kërkohet nga bashkësitë fetare, e në rastin konkret në këtë çështje të konfliktit administrativ, faturat për ritet fetare parashihet të sigurohen nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë, duke mos specifikuar këtu nëse bëhet fjalë edhe për gjëra tjera përcjellëse me rastin e funeralit e që përfshijnë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët dhe larja e të ndjerëve.

Në ndërlidhje me pikën II të dispozitivit të vendimit të të paditurës së parë, gjykata vërejt se mungon përcaktimi i qartë nëse bëhet fjalë vetëm për faturën që i referohet riteve fetare apo edhe për gjëra tjera përcjellëse me rastin e funeralit e që përfshijnë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët dhe larja e të ndjerëve.

Gjykata gjithashtu konstatoi se me vendimin e të paditurës së parë, Komunës së Prishtinës, kompanitë private, respektivisht paditësit, janë përjashtuar nga e drejta që të furnizojnë familjarët e të ndjerëve me materialet me rastin e funeralit e që përfshijnë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët dhe larja e të ndjerëve, duke u dhënë të njëjtëve vetëm mundësinë e transportimit të kufomës së personit të vdekur. Duke qenë në një situatë të tillë, paditësve u është mohuar ofrimi i shërbimeve¹ të tyre në një ambient ku konkurenca është plotësisht e lirë në treg.

Në lidhje me aktin administrativ të të paditurës së dytë, gjykata gjeti se dispozitivi apo pjesa urdhëruese, është kontradiktore me arsyetimin ashtu që nga kjo del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

¹ Ofrimi i shërbimeve nënkupton shitjen e dërrasave, shtofit (qefinit) piramidave dhe transportin e kufomave e duke përjashtuar kryerjen e riteve fetare e cila në rastin konkret është kompetencë e KBI- Prishtinë.

respektivisht nenit 48 i cili përcakton, ndër të tjera se: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërrthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se dispozitivi i këtij vendimi është i paqartë, ashtu sikurse edhe arsyetimi është i paqartë, i pamjaftueshëm dhe kundërrthënës me dispozitivin.

Në drejtim të pretendimeve të përfaqësuesit të të paditurës së dytë; Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.12.2020 duke ju referuar kërkesës së operatorëve ekonomik, pretendon se të njëjtit kanë kërkuar shërbime rituale fetare duke argumentuar se kjo çështje është ekskluziviteti i bashkësive fetare, të njëjtat i hodhi poshtë si të paqëndrueshme, për shkak se as në padi dhe as gjatë deklarimeve të tyre, të njëjtit nuk kanë kërkuar asnjëherë që të përfshihen në ofrimin e riteve fetare, për shkak se është fakt i njohur botërisht që ritet fetare performohen dhe kryhen vetëm nga personat përgjegjës të deleguar nga bashkësitë fetare.

E paditura e dytë, duhet të marr të gjitha masat e nevojshme administrative, që në rivendosje, të bashkëpunoj ngushtë me dy të paditurat tjera e veçanërisht me të paditurën e parë komunën e Prishtinës në mënyrë që të eliminohet çfarëdo zbrazëtie ligjore dhe të gjitha të metat e evidentuara në këtë Aktgjykim.

Në lidhje me vendimin e të paditurës së tretë, gjykata gjeti se edhe tek akti administrativ i të paditurës së tretë, ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht të nenit 47 i cili përcakton, ndër të tjera se: “1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”.

Në këtë drejtim, gjykata konstatoi se tek akti i kontestuar tek e paditura e tretë mungojnë të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ, të përcaktuara në nenin 47 të LPPA-së.

Në ndërlidhje me vendimet e të gjitha të paditurave, gjykata gjeti se e paditura e tretë, nuk ka paraqitur prova para Gjykatës me të cilat tregon hapat ligjor dhe veprimet konkrete se si ajo e

zbaton apo inkorporon vendimin e të paditurës së parë. Poashtu, gjykata nuk gjeti dhe nuk pranoi asnjë provë nga e paditura e tretë e cila do të paraqiste mënyrën e zbatimit të vendimit të Komunës së Prishtinës në rastet kur pjesëtarët e komunitetit musliman ndërrojnë jetë.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se arsyetimi është i paqartë dhe nuk trajton në mënyrën e përcaktuar me ligj, kërkesat specifike të paditësve.

Gjykata hodhi poshtë deklaratimet e përfaqësuesit të të paditurës së tretë, i cili në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.01.2021, ndër të tjera, tha: *“andaj BIP vetëm i ka udhëzuar popullatën që konform vendimit të komunës së Prishtinës, t’i drejtohen KBI-së si kompetente për këtë çështje, andaj mbetem pranë propozimit të mësipërm”*. Këto deklarime u hodhën poshtë për faktin se në përputhje me pikën II të dispozitivit të vendimit të Komunës së Prishtinës, përcaktohet obligimi i familjarëve që faturat si në pikën II të dispozitivit të vendimit të Komunës së Prishtinës, të sillen para organeve komunale e jo para Bashkësisë Islame në Prishtinë. Gjykatës poashtu nuk ju ofrua asnjë provë mbi bazën e asaj se si BKI i siguron dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët dhe larja e të ndjerëve, si zbatohet vendimi i të paditurës së parë Komunës së Prishtinës, e veçanërisht pika II e këtij vendimi dhe se mbi çfarë baze ligjore bëhet shpërndarja e këtyre materialeve, duke marrë parasysh faktin që misioni i së njëjtës është ofrimi i riteve fetare për pjesëtarët e komunitetit musliman e në asnjë rast ofrimi i shërbimeve të shitblerjeve të materialeve siç janë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët.

Gjykata për më tepër gjeti se çfarëdo aktiviteti i shitblerjes së materialeve siç janë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët dhe transportimi i kufomës nga ana e të paditurës së tretë, nuk përkon me natyrën e punës së BIK, e cila detyrë kryesore ka kryerjen e riteve fetare dhe jo aktivitet ekonomik, për të cilin paditësit kanë licensë dhe janë ligjërisht të regjistruar në ARBK për të kryer këto shërbime funerale.

E padiura e parë, gjatë riprocedimit dhe rishqyrtimit të vendimit të vet të atakuar nga ana e paditësve, duhet të ketë parasysh faktin që BIK, sipas rregullativës aktuale ligjore që ka, nuk mund të performoj asnjë aktivitet ekonomik që përfshinë ofrimi i shërbimeve të shitblerjeve të materialeve siç janë dërrasat, shtofin (qefinin), piramidat, arkivolët, por vetëm aktivitet të kryerjes së riteve fetare në kuptim të çështjes juridike e cila është objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë.

Gjykata gjeti se e paditura e tretë asnjëherë nuk kishte kthyer përgjigje paditësve në lidhje me shqetësimet e tyre sa i përket çështjeve të ngritura në padi. Në lidhje me këtë, e paditura e tretë asnjëherë nuk kishte kthyer përgjigje në Kërkesën e paditësve të datës 17.10.2016.

Gjykata erdhi në përfundim të qartë që vendimet e të paditurave duhet të rishikohen, të rivlerësohen dhe të rivendosen duke pasur parasysh aspektin material e formal të akteve administrative të kontestuara dhe duke u përfshirë në këtë proces Komuna e Prishtinës, Bashkësia Islame në Prishtinë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe palët e interesuara, respektivisht edhe paditësit në cilësinë e bartësve të shërbimeve funerale. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm në eliminimin e çfarëdo pengese ligjore në atë mënyrë që të sigurohet zbatimi i

plotë i aktit administrativ në të mirë të qytetarëve dhe të sigurohet barazia e plotë në tregun e shërbimeve për funerale.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo Gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative- juridike është shkelur ligji në dëm të paditësve, andaj organet e paditura do të kenë parasysh theksimet nga kërkesat e paditësve dhe të gjeturat e Gjykatës.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të kundërshtuara dhe në këtë drejtim gjykata i obligon organet e paditura, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë Aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojnë të metat e cekura, të marrin vendime të drejta dhe të bazuara në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organet e paditura, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.515/18, datë 01.02.2021

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.